



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br.No. 1948/2023
Nra iq/Bi.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 14/11/2023
PRISHTINË/PRIŠTINA-PRIŠTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio

Nr. 519/2022

në lidhje me punësimin në institucionet qendrore dhe në organet e vëtëqeverisjes lokale
në Kosovë të personave me aftësi të kufizuara

Prishtinë, më 14 dhjetor 2023

I. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky rapport ka dy qëllime kryesore:

- a. Ta verifikojë nëse niveli i punësimit të personave me aftësi të kufizuar është në përputhje me dispozitat dhe detyrimet ligjore, veçanërisht me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; me Ligjin nr. 05/L-021 Kundër Diskriminimit dhe Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2020-2023).
- b. Ta verifikojë nëse niveli aktual i punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës paraqet diskriminim të tyre, gjegjësisht nëse respektohet parimi i barazisë së tyre para ligjit.

II. BAZA LIGJORE DHE KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

1. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
2. Gjithashtu Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “*Të bëjë hetime [...] me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjeter, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë (neni 18, pika 2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, pika 5);*
 - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, pika 6);*
 - *Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoritetet e Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3)."*
3. Në bazë të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, midis të tjerash, i ka edhe kompetencat si në vijim:

- “Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit (neni 9, paragrafi 1).”
- “Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik (neni 9, paragrafi 2, pika 3).”

III. GJENDJA FAKTIKE

4. Gjatë muajit qershor të vitit 2022, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë e vizitoi organizatën HANDIKOS, me qëllim që të njihej me sfidat dhe problemet sistematike me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Me atë rast morën informatën se mungesa e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e sektorit publik është një nga problemet kryesore që e vështirëson pozitën e tyre.
5. Institucioni i Avokatit të Popullit më 24 nëntor 2022 iu drejtua me një letër Zyrës për Qeverisje të Mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe luftimin e diskriminimit (Zyra për Qeverisje të Mirë) dhe kërkoi përgjigje në pyetjen se çfarë ka bërë Qeveria për zbatimin e Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në lidhje me punësimin e tyre.
6. Po ashtu më 21 shkurt 2023 u janë dërguar letra kryetarëve të 38 komunave në Kosovë, prej të cilëve është kërkuar përgjigje në pyetjet në vijim: Sa është numri i përgjithshëm i të punësuarve në komunë dhe sa prej tyre janë persona me aftësi të kufizuara? Nëse nuk është plotësuar kuota ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, cilat janë arsyet për këtë?
7. Më 9 dhjetor 2022, Zyra për Qeverisje të Mirë i dërgoi përgjigje Avokatit të Popullit, ku thuhej se në gusht të vitit 2013 ishte miratuar Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe plani i zbatimit të kësaj strategjie dhe se Këshilli për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është funksional dhe ka funksion mbikëqyrës dhe këshillues për përcaktimin e politikave dhe prioriteteve në fushën e aftësisë së kufizuar.
8. Zyra për Qeverisje të Mirë më tej theksonte se më 23 shkurt 2022, në përputhje me Vendimin nr. 08/46 të Qeverisë, me të cilin viti 2022 është shpallur vit i personave me aftësi të kufizuar, kryeministri ka marrë vendim me të cilin obligoheshin organet e administratës shtetërore që gjatë vitit 2022 ta përmbushnin kuotën ligjore të punësimit të personave me aftësi të kufizuar.
9. Në përgjigjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë jepej një pasqyrë e gjendjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e nivelit qendror, si më poshtë:
 - Zyra e Kryeministratit ka 198 të punësuar, prej të cilëve 4 janë persona me aftësi të kufizuara.
 - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka 570 të punësuar, prej të cilëve 15 janë persona me aftësi të kufizuara.
 - Ministria e Drejtësisë ka 1880 të punësuar, prej të cilëve 15 janë persona me aftësi të kufizuara. Zyra për Qeverisje të Mirë tërheq vëmendjen për faktin se pjesa më e madhe e stafit të Ministrisë së Drejtësisë janë zyrtarë korrekta, të cilët duhet të jenë të aftë psiko-fizikisht për t'i kryer detyrat e tyre dhe për këtë arsyе është e vështirë të plotësohet kuota e një personi me aftësi të kufizuar për çdo 50 të punësuar.

- Ministria e Shëndetësisë ka 130 të punësuar, prej të cilëve 3 janë persona me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka 540 të punësuar, prej të cilëve 4 janë persona janë me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prej 360 nëpunësve civilë të punësuar, ka 8 persona me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka gjithsej 93 zyrtarë civilë, mes të cilëve 2 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Zhvillimit Rajonal ka 36 të punësuar, prej të cilëve 1 person është me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Mbrojtjes ka 124 të punësuar, prej të cilëve 17 janë persona me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe invalidët e luftës. Në Forcat e Sigurisë së Kosovës, nga 106 të punësuar, 20 janë persona me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe invalidët e luftës.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka gjithsej 242 të punësuar në Departamentin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, prej të cilëve 4 janë persona me aftësi të kufizuara; ndërsa në sektorin e infrastrukturës janë 248 të punësuar, prej të cilëve 1 person është me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit raportoi se aktualisht nuk ka asnjë person të punësuar me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Punëve të Brendshme, duke përfshirë Agjencinë e Regjistrimit Civil, Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, ka 942 të punësuar, prej të cilëve 7 janë persona me aftësi të kufizuara.
- Ministria e Ekonomisë raportoi se nuk e ka të plotësuar kuotën ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.
- Ministria për Komunitete dhe Kthim ka raportuar se nuk e ka të plotësuar kuotën ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuar.
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka 285 të punësuar, prej të cilëve 2 janë persona me aftësi të kufizuara.
- Për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Zyra për Qeverisje të Mirë nuk ka dorëzuar të dhëna.

10. Përgjigjet e njëzet e gjashtë (26) komunave sipas radhës së mbërritjes janë si në vijim:

- Komuna e Rahovecit ka gjithsej 1161 të punësuar, prej të cilëve 9 janë persona me aftësi të kufizuara. Drejtoria për Arsim ka të punësuar 659 persona, 5 prej të cilëve janë persona me aftësi të kufizuara, 2 prej të cilëve janë në pozita drejtuese; në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë të punësuar 152 persona, 1 është me aftësi të kufizuara; dhe në administratën komunale janë të punësuar 150 persona, prej të cilëve 3 janë me aftësi të kufizuara. Komuna deklaroi se do të avokojë që kjo kategori të përfshihet sa më shumë në punën e institucioneve.
- Komuna e Gllogocit ka gjithsej 149 të punësuar, prej të cilëve 2 janë persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu në këtë komunë janë të punësuar edhe 4 invalidë të

luftës. Komuna e inkurajon punësimin e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me parimin e mundësive të barabarta.

- Komuna e Fushë Kosovës ka gjithsej 153 të punësuar, prej të cilëve 1 është me aftësi të kufizuara. Asnjë person tjetër me aftësi të kufizuara nuk ka aplikuar në konkurse në këtë komunë.
- Komuna e Lipjanit ka gjithsej 177 të punësuar, prej të cilëve 3 janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Mitrovicës së Jugut ka gjithsej 308 të punësuar, prej të cilëve 7 janë me aftësi të kufizuara, 6 janë invalidë të luftës, kurse 1 person është me defekt fizik të lindur.
- Komuna e Graçanicës ka vetëm 1 person me aftësi të kufizuara (Komuna nuk ka dorëzuar të dhëna për numrin total të nëpunësve civilë). Komuna sqaron se në 5 vjetët e fundit asnjë person me aftësi të kufizuar nuk ka aplikuar për vende të lira pune në shërbimin civil dhe se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore synon që gjatë sistemimit të vendeve të punës të parashohë vende të punës të cilat mund të plotësohen nga personat me aftësi të kufizuara. Komuna po ashtu tërheq vëmendjen edhe për problemin e mospërputhjes mes neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në versionet në gjuhën shqipe dhe serbe, gjë që e vështirëson zbatimin e ligjit.
- Komuna e Klinës ka 2 persona me aftësi të kufizuara dhe nuk ka ofruar të dhëna për numrin total të të punësuarve.
- Komuna e Kaçanikut ka 128 të punësuar, prej të cilëve 3 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Pejës ka 249 të punësuar, prej të cilëve 5 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Obiliqit ka 116 të punësuar, prej të cilëve 1 person është me aftësi të kufizuara. Komuna theksoi se, sipas ligjit, duhet ta punësojë edhe një person me aftësi të kufizuara, por pavarësisht nga publikimi dhe konkursset e hapura, asnjë person me aftësi të kufizuar nuk ka aplikuar për to.
- Komuna e Vitisë, nga gjithsej 168 të punësuar në administratën komunale, asnjë person me aftësi të kufizuara nuk është i punësuar pavarësisht përpjekjeve të Komunës që ta mundësonte punësimin e tyre. Gjatë vitit 2022 me kontratën për shërbime speciale janë angazhuar 2 persona me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Ranillugut ka 189 të punësuar, prej të cilëve 2 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Novobërdës ka gjithsej 120 të punësuar dhe nuk ka të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara. Detyrimi nuk është përmbrushur për shkak se nuk ka pasur aplikacione nga ana e personave me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Parteshit nuk ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sepse nuk ka pasur aplikacione të personave me aftësi të kufizuara.

- Komuna e Shtimes ka 100 të punësuar, por nuk ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sepse në konkurset e publikuara nuk ka pasur aplikime nga persona me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Malishevës ka të punësuar 1 person me aftësi të kufizuara, ndërsa 3 persona me aftësi të kufizuara kanë qenë të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta.
- Komuna e Ferizajt ka 287 të punësuar, prej të cilëve 6 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Podujevës ka 261 të punësuar, prej të cilëve 3 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Gjakovës ka 323 të punësuar, prej të cilëve 6 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Shtërpçës ka 106 të punësuar, prej të cilëve 1 person është me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Skenderajt ka të punësuar 6 persona me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Dragashit ka 741 të punësuar, prej të cilëve 10 persona janë me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Kllokotit ka 132 të punësuar, por nuk e ka të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, sepse nuk ka pasur aplikime nga ana e kandidatëve me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Mamushës ka 35 të punësuar, por nuk e ka të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, sepse nuk ka pasur aplikime nga ana e personave me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Hanit të Elezit ka 69 të punësuar, të cilët punojnë në administratën komunale dhe 237 të punësuar në të gjitha institucionet publike. Nga ky numër i të punësuarve asnjë nuk është me aftësi të kufizuara.
- Komuna e Suharekës i ka të punësuar 3 persona me aftësi të kufizuara.

11. Më 23 prill 2023 zëvendësi i Avokatit të Popullit u takua me përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare për Punësim. Kjo agjenci ka bërë me dije se çdo person në moshë pune (15-64) mund të regjistrohet në Agjenci si punëkërkues. Të dhënat ruhen në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Punësimit dhe çdo 3 muaj klienti mund të vijë në Agjenci dhe t'i përditësojë të dhënat në profilin e tij.

12. Për trajnimin e personave me aftësi të kufizuar, Agjencia e Punësimit ka bërë me dije se përmes qendrave të formimit profesional ofron trajnime për të gjithë punëkërkuesit e interesuar për aftësim profesional. Qendrat e aftësimit profesional, që janë në kuadër të Agjencisë, zhvillojnë trajnime profesionale për personat me aftësi të kufizuara, ku një pjesë e trajnerëve janë trajnuar në vitet 2017-2018 për gjithëpërfshirjen e personave me invaliditetin e Sindromës Down dhe është përgatitur doracaku për gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuar. Qendrat e aftësimit profesional lëshojnë certifikata të trajnimit të përfunduar. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë certifikuar 35 persona me aftësi të kufizuara dhe gjatë periudhës janar-mars 2023, 31 persona të tjera. Trajinimet

janë organizuar për rrobaqepës, asistentë administrativë, kuzhinierë, pasticeri, dizajn grafik dhe teknologji informative.

13. Agjencia e Punësimit nuk ka informuar se si realizohet konkretisht punësimi i personave me aftësi të kufizuara, përveç informacionit se ka një plan individual punësimi për të gjithë punëkërkuesit që janë kategorizuar në kategorinë e rrezikut të lartë për të mbetur të papunë për një kohë të gjatë. Gjatë vitit 2022, nga 214 persona me aftësi të kufizuar të regjistruar në Agjenci, 10 prej tyre janë punësuar.

IV. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

14. Me qëllim të vërtetimit të fakteve dhe të rrethanave juridikisht relevante lidhur me çështjen e përmendur, Avokati i Popullit bëri një analizë të detajuar të instrumenteve relevante ligjore dhe strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të përcaktuar nëse praktikat ekzistuese të punësimit i cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të drejtat e tyre për punë dhe punësim në sektorin publik në nivel qendror dhe lokal.

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta)

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...].”

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

“1. E drejta e punës garanton.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

“4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.”

16. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejmë: Konventa) është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 22) dhe ka

prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Neni 14 i Konventës

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa diskriminimin në asnje bazë [...].”

Neni 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës thekson:

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnje diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

17. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Neni 1

“Qëllimi i kësaj Konverte është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gjojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.”

Neni 2

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gjëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.”

Neni 27

“1. Shtetet Palë njojin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e popullësisë; këtu përfshihet e drejta për të patur mundësinë për të fituar jetesën duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe vendin/ambjentin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar. Shtetet Palë do të mbrojnë dhe inkurajojnë realizimin e të drejtës për punë, duke përfshirë dhe personat që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore me qëllim që ndër të tjera:

(a) të ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e pajtimit në punë, punësimit, vazhdimësisë së punësimit, ecjes në karrierë dhe ofrimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës;

(b) mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, njësoj si gjithë të tjerët, duke përfshirë garantimin e mundësive të barabarta dhe pagesës të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, duke përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe zgjidhjen e ankesave;

- (c) për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar të jenë në gjendje të ushtrojne të drejtat e punës dhe te drejtat sindikaliste njësoj si gjithë të tjerët; [...];
- (g) punësimin e personave me aftësi të kufizuar në sektorin publik; [...].”

18. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

Neni 1

“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

Neni 2

“1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:

- 1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; [...].”

Neni 3

“1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkuption se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose cenoj njohjen, gjëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

Neni 8

“Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.”

19. Ligji nr. 03/L-212 i Punës

Neni 5

“1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.”

Neni 47

“1. I punësuari tek i cili paraqitet aftësia e kufizuar, ka të drejtë të punojë në punën e tij ose sipas përshkrimit të punës ose punë tjera përkatëse, nëse sipas aftësisë së mbetur për punë mund ta kryejë atë punë pa rehabilitim profesional.

2. I punësuari të cilat i është zvogëluar aftësia shëndetësore për punë pas rehabilitimit profesional është aftësuar të kryejë punë të caktuara, konsiderohet i aftë për kryerjen e atyre punëve.”

20. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Neni 5

“1. Diskriminimi përfshin çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, i cili konsiston ne mosdhënien e mundësive të barabarta ose trajtimit jo te barabartë në punësim apo në profesion.

2. Çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune në bazë të aftësive të caktuara që kërkohen për atë vend pune, nuk konsiderohet si diskriminim.

3. Ndalohet çdo lloj diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar ju garantohet mbrojtje ligjore e barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.”

Neni 10

“1. Politikat qeveritare përkitazi me aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara do të përfshijnë:

- 1.1. aftësimin, riaftësimin profesional dhe format tjera të mbështetjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- 1.2. parimet, mënyra e veprimit dhe metodat e përgaditjes profesionale të zbatuara përgjithësisht në kualifikimet e personave të tjera, zbatohen në rastet e personit me aftësi të kufizuar, deri në atë mase sa lejojnë aftësitë e tij;
- 1.3. masat e mundshme dhe të nevojshme për të krijuar dhe zhvilluar shërbimet e specializuara të aftësimit profesional për personat me aftësi të kufizuara, që kërkojnë ndihmë për gjetjen e punës dhe avancim në vendin e punës;
- 1.4. plan programet mësimore sipas sistemit modular që mundësojnë aftësim individual për personat me aftësi të kufizuara;
- 1.5. aftësimin e përbashkët të personave me aftësi të kufizuara me të tjerët, në hapësirë të njëjtë dhe trajner të njëjtë me qëllim të integrimit të tyre në shoqëri;
- 1.6. angazhimin e institacioneve që ofrojnë aftësim profesional, për të krijuar mjedis fizik tëpërshtatshëm për qasje pa vështirësi për personat me aftësi të kufizuara;

1.7. aftësimin e personelit administrativ dhe teknik të institucioneve për aftësim, riaftësim dhe punësim, të cilët drejtpërsëdrejti punojnë me personat me aftësi të kufizuara.”

Neni 12

“2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij nenit, obligohet qe për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të paguaj në buxhetin e Kosovës kontribuite mujore në lartësi prej një përqind (1%) të shumës së pagës minimale.”

21. Strategja për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2023)

“Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të brabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.”

V. ANALIZA E RASTIT

22. Duke pasur parasysh çështjen e nivelit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në përputhje me dispozitat dhe detyrimet ligjore, Avokati i Popullit do ta analizojë këtë çështje nga aspekti i respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut si dhe legjislacionit kundër diskriminimit.

23. Avokati i Popullit e nënizon se Kushtetuta dhe legjislacioni kundër diskriminimit përcaktojnë parimin e barazisë pa asnjë diskriminim të tèrthortë apo të drejtpërdrejtë, pasi është rregulluar që të gjithë janë të barabartë dhe gjëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë juridike, pavarësisht nga karakteristikat personale dhe se secili është i detyruar ta respektojë parimin e barazisë, pra ndalimin e diskriminimit.

24. Neni 24, paragrafi 1, i Kushtetutës e përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit, ndërsa neni 24, paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të statusit personal, siç është aftësia e kufizuar. Avokati i Popullit e vlereson se kjo dispozitë kushtetuese synon të sigurojë të drejta të barabarta individuale dhe trajtum të barabartë, sepse diskriminimi është i ndaluar dhe askush nuk mund të diskriminohet në bazë të aftësisë së kufizuar apo ndonjë statusi tjeter personal.

25. Neni 49 i Kushtetutës garanton të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit dhe parashikon se e drejta për punë është e garantuar dhe se çdo person e zgjedh lirisht profesionin dhe vendin e punës. Kushtetuta shprehimisht thotë se është detyrë e të gjitha autoritetet e respektuar nga të gjithë. Përjashtim bëjnë kufizimet e përcaktuara në mënyrë legitime në përputhje me legjislacionin ekzistues, ku duhet të respektohet raporti i proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të vendosur dhe qëllimit të dëshiruar.

26. Për më tepër, Avokati i Popullit rikujton se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa sipas nenit 53 të Kushtetutës, të

drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

27. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 14 e ndalon diskriminimin dhe garanton që gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë të sigurohen pa asnjë dallim të bazuar në asnjë status. Protokolli 12, nen 1, i Konventës parashikon më tej një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit dhe parashikon se askush **nuk mund të diskriminohet nga autoritetet për ndonjë nga arsyet e mësipërme, kur karakteristikat personale ose statusi tjetër përfaqësojnë tipare të mbrojtura nga diskriminimi.**
28. Avokati i Popullit e thekson se sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: “*E drejta për të mos u diskriminuar shkelet kur shtetet i trajtonë njerëzit në mënyrë të pabarabartë [...] pa dhënë arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm.*”¹ Që një arsyetim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm” duhet të kalojë nëpër dy hapa: Së pari, duhet të ekzistojë një “qëllim legjitim” për pabarazinë në fjalë; dhe së dyti duhet të ekzistojë gjithash tu një “marrëdhënie e arsyeshme e proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit” i cili synohet. Gjykata, me rastin e vendosjes për rastet e diskriminimit, do ta zbatojë testin: a) A ka pasur dallime në trajtimin e personave në situata analoge ose përkatësisht të ngjashme - apo ekziston dështimi për t’i trajtuar ndryshe personat në situata të ndryshme përkatëse? b) Nëse ekziston, a është arsyetuar objektivisht një dallim i tillë apo mungesa e dallimit? Konkretisht, a ka trajtimi një qëllim legjitim? A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin e synuar?
29. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar se veprimtaria e nenit 14 të Konventës dhe e nenit 1 të Protokollit nr. 12 e përfshijnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, kushteve shëndetësore ose karakteristikave gjenetike.² Në rastet që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar, “*fusha e diskrecionit të shteteve në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor të personave me aftësi të kufizuara është reduktuar shumë.*”³ Duke iu referuar veçanërisht Rekomandimit 1592 (2003) për përfshirjen e plotë shoqërore të personave me aftësi të kufizuara, i cili u miratua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës⁴, dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,⁵ Gjykata vlerëson se “*ekziston një konsensus evropian dhe botëror për nevojën për mbrojtjen e personave me aftësi të organizuara nga trajtimi diskriminues.*”⁶
30. Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e tij të përgjithshëm nr. 5 (1994) thekson: “*Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara ka një histori të gjatë dhe zbatohet në forma të ndryshme. Ato variojnë nga diskriminimi i hapur, p.sh. mohimi i mundësive arsimore, deri te format "delikate" të diskriminimit si ndarja dhe izolimi i arritur me vendosjen e barrierave fizike dhe sociale.[...]. Përmes*

¹ Shih *Molla Sali kundër Greqisë* [GC], 2018, parag. 135; *Fabris protiv Francuske* [GC], 2013, parag. 56; *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC], 2007, parag. 175.

² Glor kundër Zvicrës, Aplikacioni 13444/04, 2009, fq. 80; Kiyutin kundër Ruse, Aplikacioni, 2700/10, 2011, fq. 57.

³ Glor kundër Zvicrës, Aplikacioni 13444/04, 2009, fq. 84.

⁴ E miratuar më 29 janar 2003.

⁵ E miratuar më 13 dhjetor 2006.

⁶ Glor kundër Zvicrës, Aplikacioni 13444/04, 2009, fq. 53.

neglizhencës, injorancës, paragjykimeve dhe supozimeve të rreme, si dhe përmes përjashtimit, diskriminimit ose ndarjes, personat me aftësi të kufizuara shumë shpesh pengohen të ushtrojnë të drejtat e tyre ekonomike, sociale ose kulturore në baza të barabarta me personat pa aftësi të kufizuar. Efektet e diskriminimit të bazuar në aftësi të kufizuara janë veçanërisht të rënda në fushat e arsimit, punësimit, strehimit, transportit, jetës kulturore dhe qasjes në vende dhe shërbime publike.”

31. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përpinqet ta luftojë diskriminimin, pra qëndrimet dhe mjediset negative që i sjellin personat me aftësi të kufizuara në situata të cenueshme ose të margjinalizuara. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, pra siç përcaktohet në nenin 2: “*Çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtimit, njësoj si gjithë të tjerët, [...].*”
32. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nenit 27 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili parashikon: “*a) Të ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, [...];* b) *mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, njësoj si gjithë të tjerët, duke përfshirë garantimin e mundësive të barabarta dhe pagesës të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, [...]. Për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar të janë në gjendje të ushtrojne të drejtat e punës dhe te drejtat sindikaliste njësoj si gjithë të tjerët; [...];* g) *punësimin e personave me aftësi të kufizuar në sektorin publik;* Me këtë Konventa kërkon t'i heqë barrierat që e vështirësojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
33. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi e definon mbrojtjen nga diskriminimi duke e përcaktuar në nenin 1 se qëllimi i këtij ligji është “*përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit*”, midis të tjerash edhe në bazë të aftësisë së kufizuar. Sipas nenit 2, paragrafi 1.3, të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “*Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore [...] të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi [...] në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës.*” Në të njëjtën kohë, nen 3, pika 1, i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashev parimin e trajtimit të barabartë, gjegjësisht se nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të ndonjë baze të mbrojtur, ku përfshihet edhe aftësia e kufizuar, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen e definon diskriminimin si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë*” në bazë të cilësdo bazë të mbrojtur ligjërisht, siç është aftësia e kufizuar. Sipas nenit 8 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të gjitha institucionet janë të obliguara të veprojnë në pajtim me këtë ligj gjatë zbatimit të veprimtarisë së tyre.
34. Ligji nr. 03/L-212 i Punës, në nenin 5 e ndalon diskriminimin në punësim dhe thekson në paragrafin 1 se diskriminimi është i ndaluar gjatë punësimit dhe në profesion, lidhur me rekrutimin, trajnimin, avancimin, kushtet e punës, masat disiplinore dhe të gjitha çështjet e rregulluara me ligj. Neni 5, paragrafi 2, në mënyrë të veçantë i mbron personat me aftësi të kufizuara: “*Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi*

të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.”

35. Për më tepër, Ligji nr. 03/L-212 i Punës e parasheh mbrojtjen e veçantë për persona me aftësi të kufizuara. Neni 47, paragrafi 1, parasheh: “*I punësuari tek i cili paraqitet aftësia e kufizuar, ka të drejtë të punojë në punën e tij ose sipas përshkrimit të punës ose punë tjera përkatëse, nëse sipas aftësisë së mbetur për punë mund ta kryejë atë punë pa rehabilitim profesional.*” Kurse në paragrafin 2: “*I punësuari të cilit i është zvogëluar aftësia shëndetësore për punë pas rehabilitimit profesional është aftësuar të kryejë punë të caktuara, konsiderohet i aftë për kryerjen e atyre punëve.*”
36. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara i rregullon të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësimit, riaftësimit profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të integrimit të tyre në tregun e hapur të punës. Sipas nenit 5, paragrafi 3, të këtij ligji: “*Ndalohet çdo lloj diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar ju garantonohet mbrojtje ligjore e barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.*”
37. Tute Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 10, paragrafi 1, parasheh edhe politikat qeveritare përkitazi me aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Këto politika përfshijnë një sërë masash duke filluar nga trajnimi dhe përgatitja profesionale, përmes shërbimeve të specializuara të formimit profesional për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë për të gjetur një punë, një plan dhe program arsimor të përshtatshëm, krijimin e një mjedisi të përshtatshëm fizik për formimin profesional dhe trajnimin e personelit administrativ dhe teknik të institucioneve të trajnimit, rikualifikimit dhe punësimit, të cilët punojnë drejtpërdrejt me persona me aftësi të kufizuara.
38. Sipas nenit 11, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në punësim dhe integrim në tregun e punës.
39. Posaçërisht është e rëndësishme dispozita 12, paragrafi 2, e Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila parasheh: “*Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuar në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.*” Neni 12, në paragrafin 3, parasheh: “*Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, obligohet qe për nxijen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të paguaj në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej një përqind (1%) të shumës së pagës minimale.*” Me këto dispozita, ligjvënësi përpinqet të krijojë një mjedis që e garanton dhe e inkurajon punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
40. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2020-2023) udhëhiqet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ajo niset nga premisa se është e domosdoshme heqja e të gjitha pengesave dhe barrierave që krijojnë vështirësi lidhur me realizimin e parimit të mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara. Strategjia synon t'i harmonizojë të gjitha politikat e veprimit për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara,

në përputhje me standartet në nivel global, me tendencën për t'i bërë të gjitha sferat e jetës të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Strategjia udhëhiqet nga vizioni i një shoqërie gjithëpërfshirëse, në të cilën personat me aftësi të kufizuara e realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe e jetojnë një jetë të dinjitetshme si qytetarë të barabartë.

41. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2020-2023) e definon si Objektiv Strategjik 2: “*Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të brabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.*” Duke krijuar mundësi të barabarta punësimi, personave me aftësi të kufizuara u mundësohet të bëjnë punë sipas zgjedhjes së tyre, të hyjnë në tregun e punës dhe ta realizojnë potencialin e tyre në një mjeshtëri pune të hapur dhe të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara.
42. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e vëren se aktualisht punësimi i personave me aftësi të kufizuara është në nivel të ulët dhe është e nevojshme të zhvillohen dhe forcohen politikat e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me potencialin e tyre fizik dhe intelektual. Kjo është arsyja pse Strategjia përpinqet që punësimin e personave me aftësi të kufizuara ta bëjë prioritet në Kosovë, si një nga elementet kyçë për përfshirje sociale dhe pavarësi ekonomike për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që janë në moshë pune.
43. Nga analiza e përgjigjeve të marra nga Zyra për Qeverisje të Mirë është konstatuar se Qeveria i ka miratuar masat e nevojshme për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në nivel qendror, me vendimin me të cilin viti 2022 ishte shpallur si vit i personave me aftësi të kufizuara, obligohen organet e administratës shtetërore që gjatë vitit 2022 ta plotësonin kuotën ligjore të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.
44. Zyra për Qeverisje të Mirë e ka përbushur plotësisht detyrimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
45. Qeveria, Zyra për Qeverisje të Mirë; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Zhvillimit Rajonal; dhe Ministria e Mbrojtjes e kanë përbushur plotësisht detyrimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
46. Për sa u përket ministrive, tri ministri: Ministria e Ekonomisë; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e kanë përbushur obligimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sepse nuk e kanë punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara.
47. Ministria e Drejtësisë; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Mjesdit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, por në numër të pamjaftueshëm, kështu që mund të konstatohet se ata nuk e kanë përbushur plotësisht detyrimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.
48. Komunat e Lipjanit, ajo e Mitrovicës Jugore, e Kaçanikut, e Glogocit, e Ferizajt, e Gjakovës dhe e Pejës e kanë përbushur plotësisht obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

49. Komunat e Vitisë, e Novobërdës, e Parteshit, e Shtimes, e Kllokotit, e Mamushës dhe e Hanit të Elezit nuk e kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara dhe nuk e kanë përbushur obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
50. Komunat e Klinës, e Skenderajt, e Graçanicës dhe e Suharekës kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, por nuk kanë ofruar të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve, kështu që nuk është e mundur të vlerësohet nëse e kanë përbushur obligimin ligjor.
51. Komuna e Rahovecit, e Fushë Kosovës, e Obiliqit, e Ranillugut, e Malishevës, e Podujevës, e Shtërpcës, e Dragashit kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, por në numër të pamjaftueshëm, kështu që nuk mund të konsiderohet se e kanë përbushur obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.
52. Komunat (dymbëdhjetë prej tyre): Prishtinë, Prizren, Gjilan, Vushtrri, Kamenicë, Deçan, Istog, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Junik nuk iu përgjigjën kërkesës së Avokatit të Popullit dhe nuk dorëzuan përgjigje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
53. Avokati i Popullit vëren se komunat të cilat nuk iu përgjigjën kërkesës së Avokatit të Popullit, nuk e kanë përbushur obligimin ligjor që rrjedh nga neni 132, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili shprehimisht i obligon të gjitha institucionet e sistemit të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit dhe thekson: “*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kérkuara në pajtim me ligj.*” Me këtë rast Avokati i Popullit i fton të njëjtat të bashkëpunojnë.
54. Nga sa u tha më sipër, Avokati i Popullit nxjerr konkluzionin se nevojitet më shumë përpjekje qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë lokal, që institucionet ta përbushin detyrimin e tyre ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sepse ende është i pamjaftueshëm numri i institucioneve që e kanë përbushur plotësisht detyrimin e tyre ligjor. Kjo veçanërisht në drithën e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Objektivi strategjik 2 i së cilës parashikon ofrimin e mundësive të barabarta të punësimit për persona me aftësi të kufizuara, ende nuk është përbushur plotësisht.
55. Avokati i Popullit e thekson se duke punësuar një person me aftësi të kufizuara për çdo pesëdhjetë punëtorë, institucionet dhe organizatat e konfirmojnë pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me kërkesat ligjore. Duke e përbushur detyrimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, institucionet e respektojnë barazinë dhe mosdiskriminimin, por edhe i përbushin detyrimet e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara është kyç për parandalimin e diskriminimit dhe arritjen e barazisë. Ai i fuqizon individët, promovon përfshirjen sociale, thyen barrierat, ushqen diversitetin, ndryshon qëndrimet dhe e mundëson zbatimin e mbrojtjes ligjore. Duke ofruar mundësi të barabarta punësimi, shoqëritë e krijojnë një mjedis më të larmishëm dhe të drejtë për të gjithë.
56. Avokati i Popullit rikujton se punësimi i personave me aftësi të kufizuara e promovon gjithëpërfshirjen dhe diversitetin në vendin e punës. Kjo e krijon një fuqi punëtore më përfaqësuese që pasqyron popullsinë më të gjerë, duke e inkurajuar ndjenjën e përkatësisë

së të gjithë të punësuarve. Gjithashtu punësimi i personave me aftësi të kufizuara ndihmon në kapërcimin e barrierave dhe të paragjykimeve, me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, duke ua mundësuar atyre të kontribuojnë me aftësitë, talentet dhe perspektivat e tyre, por edhe e promovon mirëkuptimin, ndjeshmérinë dhe respektin midis punonjësve dhe ndihmon në thyerjen e stereotipave dhe stigmës, që lidhen me aftësitë e kufizuara. Duke punësuar persona me aftësi të kufizuara, punëdhënësit përdorin aftësi, përvoja dhe qasje të ndryshme për zgjidhjen e problemeve.

VI. KONKLUZIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

57. Është e padiskutueshme se personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga aftësitë e tyre, kanë të drejta dhe nevoja që shteti është i detyruar t'i përmbushë në bazë të konventave dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe në bazë të legjisacionit aktual në Republikën e Kosovës. Prandaj Qeveria e Kosovës si synim kryesor të të gjitha politikave duhet ta ketë përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, përfshirë këtu edhe jetën e personave me aftësi të kufizuara, duke arritur rezultate të qëndrueshme në përfshirjen e tyre në shoqëri.
58. Diskriminimi dhe marginalizimi i personave me aftësi të kufizuara është një nga stigmat më të këqija shoqërore që ende është e pranishme në shoqërinë kosovare në tregun e punës, qoftë për shkak të qëndrimeve negative ndaj tyre, qoftë për shkak të konkurrencës së fuqisë “së shëndoshë” punëtore.
59. Cënueshmëria e dokumentuar gjatë punësimit të kësaj kategorie të popullsisë kërkon masa specifike të synuara të qeverisë, të cilat do ta mundësojnë zgjidhjen universale të sfidave në tregun e punës që të arrihet qëllimi i sigurimit të të drejtave dhe të mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe të zbatohen dispozitat përkatëse të instrumenteve ligjore në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.
60. Në vijim të asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit nxjerr konkluzionin se në punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dështimi i autoriteteve publike që plotësisht t'i zbatonin dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të aftësisë së kufizuar, i përcaktuar në nenet 1 dhe 4, paragrafi 1, pika 1 dhe pika 8, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në bazë të asaj që u tha më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*” Në kuptim të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, përgjegjësi e Avokatit të Popullit është: “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla, [...]*”; si dhe: “*Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës* (neni 18, paragrafi 1.7). Prandaj

REKOMANDON

Për institucionet e sistemit në nivel qendror, të cilat nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, që:

- *Ministria e Ekonomisë të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria për Komunitete dhe Kthim të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

Për institucionet e sistemit në nivel qendror, të cilat nuk e kanë përbushur plotësisht detyrimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, që:

- *Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Punëve të Brendshme të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

Për institucionet e sistemit në nivel lokal, të cilat nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, që:

- *Komuna e Vitisë të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Novobërdës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Parteshit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

- *Komuna e Shtimes tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Kllokotit tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Mamushës tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Hanit tē Elezit tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*

Për institucionet e sistemit në nivel lokal, të cilat nuk e kanë pērbushur plotësisht detyrimin ligjor për të punësuar persona me aftësi tē kufizuara, që:

- *Komuna e Rahovecit tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Fushë Kosovës tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Obiliqit tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Ranillugut tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Malishevës tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Podujevës tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Shterpëcës tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*
- *Komuna e Dragashit tē ndērmarrē masa tē synuara specifike që nē pērputhje me rregullativën ligjore t'i pērbushë detyrimet ligjore lidhur me punēsimin e personave me aftësi tē kufizuara.*

Për institucionet e sistemit në nivel lokal, të cilat kanë të punësuar persona me aftësi tē kufizuara, por nuk kanë paraqitur të dhëna për numrin total të të punësuarve, nuk mund të vlerësohet nëse e kanë pērbushur plotësisht detyrimin ligjor, prandaj, nëse nuk e kanë

përmbushur plotësish detyrimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, atëherë:

- *Komuna e Klinës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Graçanicës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Suharekës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Skenderajt të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

Për institucionet e sistemit në nivel lokal, të cilat nuk e kanë përbushur detyrimin ligjor që rrjedh nga neni 132, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në qoftë se nuk e kanë përbushur plotësish detyrimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, atëherë:

- *Komuna e Prishtinës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Prizrenit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Gjilanit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Vushtrrisë të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Kamenicës të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Deçanit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Istogut të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

- *Komuna e Mitrovicës së Veriut të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Leposaviqit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Zveçanit të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Zubin Potokut të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Komuna e Junikut të ndërmarrë masa të synuara specifike që në përputhje me rregullativën ligjore t'i përbushë detyrimet ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit